**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**NOTERE REZARTA B.KOÇI**
Nr. 5445 Rep.
Nr. 1508 Kol.

## KONTRATË SHITJE "KUOTASH"

Në Tiranë, sot më 02.07.2019 (dymijë e nentembëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën Blv "Zogu I Pare", Njesia Nr. 9, u paraqitën personalisht:

**SHITESI:**
**Z. Klodian Shqiponja,** i biri i Feim, i datelindjes 27.07.1979, lindur ne Bulçar, Alb dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 034067985 dhe me nr personal H90727058S.**(ortak me 50% te kuotave) te shoqerise "Digital Signage Advertising"**

**Z. Anteo Grëmi**, i biri i Sokrat, i datelindjes 13.05.1981, lindur ne Divjake, Lushnje dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 028772234 dhe me nr personal I10513184W. **(ortak me 50% te kuotave) te shoqerise "Digital Signage Advertising"**

**BLERESI :**
**Z. Gjelbrim Hajdari ,** i biri i Shaqir-it, me datëlindje 04.06.1977, lindur në Shtiqen Kukës dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjetletërnjoftimit elektronik me nr 031694450 dhe me nr personal H70604041T

**BAZA LIGJORE**: Nenet 761 e vijues të Kodit Civil.

Palët me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate, në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:

### TË DHËNA PARAPRAKE:

I. Shitesit jane ortak te 100% te kuotave te shoqerise "te shoqerise "**Digital Signage Advertising" shpk, perkatesisht :**

-Klodian Shqiponja, ortak me 50% te kuotave;
-Anteo Grëmi, ortak me 50% te kuotave.

Në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakut te vetëm të Shoqërisë "te shoqerise "**Digital Signage Advertising"**" shpk, është rënë dakort të bëhet shitja e 100% te kuotave qe ortaket kane te Shoqeria "te shoqerise "**Digital Signage Advertising"**" shpk te bleresi ZnjGjelbrim Hajdari

II. Bleresi behet ortak i shoqerise me 100 % te kuotave.

III. Në bazë të udhëzimit nr. 2007/1, datë 2.3.2010, të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është kërkuar informacion nga noteri sipas njoftimit D pranë Regjistrit të Barrëve Siguruese dhe nga përgjigjja e dhënë nga RBS, rezulton se mbi kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë "te shoqerise "**Digital Signage Advertising**""shpk nuk rezulton asnjë barrë siguruese.

**NENI 1**
**Objekti**

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave të inidividualizuara nga shitesi te bleresit kundrejt çmimit te percaktuar ne nenin 2 të kesaj kontrate.

**NENI 2**
**Çmimi**

**2.1.** Shitësi ia shet këto kuota blerësit kundrejt një çmimi 10000 lekë (dhjetë mijë lekë), të vlerës nominale. Palët deklarojnë se çmimi është paguar i plotë jashtë kësaj zyre noteriale nga blerësit në favor të shitësit, të cilët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njeri tjetrit.

**2.2.** Me kete çmim te likujduar dhe me blerjen e kuotave te kesaj shoqerie, bleresi nuk merr persiper detyrimet qe ortaket kane ndaj njeri-tjetrit.

**NENI 3**
**Kalimi i pronësisë**

Me nënshkrimin e kontratës se shitjes dhe me regjistrimin e saj ne zyrat e QKB-se, bleresit i kalon pronesia mi kuotat e blera menjehere, te lira dhe pa barre.
Me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi Z. Gjelbrim Hajdari **behet ortak i vetem me 100% te kuotave te shoqerise "**te shoqerise "**Digital Signage Advertising"" shpk.**

**NENI 4**
**Të ndryshme**

**5.1.** Palët u porositën që të depozitojnë kontratën pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit për të bërë rregjistrimet përkatëse ;

**5.2.** Kjo kontrate është hartuar në bazë te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës se Shqipërisë. Çështjet që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil;

**5.3.** Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata iu lexohet palëve te cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 102 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.10.2018 "Për Noterinë"
Kontrata redaktohet në tre kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, nga të cilat një kopje ruhet në arkivin e noteres.

**SHITESI** | **BLERESI**

Klodian Shqiponja | GJELBRIM HAJDARI

Anxhelo Cremi

**NOTERE**
**REZARTA B. KOÇI**

SHOQËRIA TREGTARE
"Digital Signage Advertising" shpk
TIRANË

VENDIM NR 1, DATË 28.06.2019
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TE SHOQËRISË TREGTARE
"Digital Signage Advertising" shpk

Në Tirane, sot në datën 28 muaji qershor viti 2019 u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqërisë Tregtare "**Digital Signage Advertising" shpk**, në selinë e saj, perkatesisht :

**Z. Klodian Shqiponja,** i biri i Feim, i datelindjes 27.07.1979, lindur ne Bulçar, Alb dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 034067985 dhe me nr personal H90727058S.(ortak me 50% te kuotave)
**Z. Anteo Grëmi**, i biri i Sokrat, i datelindjes 13.05.1981, lindur ne Divjake, Lushnje dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 028772234 dhe me nr personal I10513184W. (ortak me 50% te kuotave)

për shqyrtimin e rendit të ditës:

a) Shitjen e 100% (njeqind përqind) të kuotave qe Z. Klodian Shqiponja dhe Z. Anteo Grëmi kane te shoqëria **"Digital Signage Advertising"** shpk, duke i shitur te Z. Gjelbrim Hajdari.

Asambleja e ortakëve, pasi u njoh me rendin e ditës;

VËREN SE

Shoqëria Tregtare "Digital Signage Advertising" Shpk është e regjistruar ne Shqiperi dhe eshte e pajisur me NIPT me nr L21410012I.

Asambleja e ortakëve e shoqërisë tregtare **"Digital Signage Advertising" shpk** pas shqyrtimit të rendit të ditës;

VENDOSI

- Shitjen e 100% (njeqind perqind) të kuotave qe ortaket kane kanë tek Shoqëria **"Digital Signage Advertising" shpk** tek **Z.Gjelbrim Hajdari.**
- Miratojnë kontratën e shitjes së 100% (njeqind perqind) të kuotave qe ortaket kane tek Shoqëria **"Digital Signage Advertising " shpk** tek **Z.Gjelbrim Hajdari.**
- Me shitjen e 100% te kuotave qe ortaket Klodian Shqiponja dhe Anteo Grëmi kane tek Shoqëria **"Digital Signage Advertising" Shpk, ata nuk jane me ortake dhe** ortak i vetem i shoqerise "**Digital Signage Advertising" shpk behert Z. Gjelbrim Hajdari.**

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQËRISË TREGTARE
"Digital Signage Advertising"shpk

Klodian Shqiponja

Anteo Grëmi

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@rcen-al.com

# REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2019070217959694 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 02.07.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 5:09:59PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-626-1586 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

## LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DIGITAL SIGNAGE ADVERTISING SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA